



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Seksioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit

Procesverbal

Mbledhja e mbajtur me 18. 06.2013, duke filluar në orën 11:00

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, kryetar, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi;

Munguan: Mufera Sinik, dhe Jasmina Zivkovic, anëtarë

Nga Zyra mbështetëse morën pjesë: Fehmi Hyseni, Advie Morina dhe Manush Krasniqi;

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;çç
- 2..Shqyrtimi i Projektligjit për te Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit.;
3. Shqyrtimi i Projekt rregullores së Kuvendit të Republikës se Kosovës;
4. Përfundimi Nr. 04-V-610;
5. Te ndryshme.

.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Nënkomisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

Shqyrtimi i Projekt rregullores së Kuvendit të Republikës se Kosovës;
Përfundimi Nr. 04-V-610;

Armend Zemaj-kryetar i Nënkomisioni për mandate dhe imunitete hapi mbledhjen për shqyrtimin e draf-rregullores së Kuvendit, dhe njeherit shqyrtimin e përfundimin Nr. 04-V-610 të Kryesisë së Kuvendit ku preferohet që në tekstin përfundimtar të përfshihen të gjitha propozimet që kanë të bëjnë me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari- theksoi se nuk ka nevojë për ndërhyrje ne këtë dokument pasi qe jam konsultuar edhe me shefat e grupe parlamentare ,dhe njherit e kontestoj edhe disa ndërhyrje te Gjykatës Kushtetuese, ku është proceduar për votim të dytë Rregulloren e re të punës së Kuvendit, duke mos bërë ndërhyrje në të, pavarësisht kërkesës së Kryesisë që të shqyrtohet disa vendime te Gjykatës Kushtetute që kanë të bëjnë me veprime të deputeteve brenda seancave.

Në nga veprimet Kushtetuesja kishte vlerësuar se deputetet pasi të paraqesin prezencën, janë te obliguar që të votojnë për, abstenim ose kundër.

Ardian Gjini- thotë se deputeti është i lirë dhe askush nuk mund ta detyrojë të votojë kur ai nuk e sheh te arsyeshme një gjë të tillë, ai mund te jetë në sallë dhe mos te votoj ,është vullnet personal. Prezenca e tij e bene kuorumin dhe vota mund te mos hidhet. Andaj duhet ta përcjellim këtë dokument për procedim.

Anëtarët e Nenkomisioni kane vlerësuar se rregullorja e re është mire e përpunuar dhe nuk ka asnjë arsye te që ky dokument të hyjë ne rishqyrtim. Rregullorja e re kohë ma pare është vonuar ne lexim te parë nga deputetet, por kur është sjellë për lexim te dytë ,ajo ishte tërhequr nga rendi i ditës, për këtë deputetet dyshojnë se ajo nuk po hynë ne votim për disa arsye tjera.

Pas diskutimeve dhe angazhimeve të të gjithë anëtarëve për projektin në fjalë u nxor ky

Përfundim

Nenkomisioni për mandate dhe imunitete miratojë me vota unanime Projekt rregulloren e Kuvendit të Republikës se Kosovës te cilën e dërgon ne komisionin për Legjislacion për procedim te mëtejme

Ndërsa pika e dytë e rendit të ditës mbetet të shqyrtohet ne mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi ne ora 12.30.

Kryetar i Nenkomisionit

Armend Zemaj

